



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 11 nëntor 2021
Nr. ref.:RK 1892/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI190/20

Parashtrues

Ryve Muqolli dhe të tjerët

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të
Kosovës Rev.nr.92/2018 i 18 dhjetorit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesit e kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Ryve Muqolli, Agnesa Broqi, Agon Broqi, Orgesa Broqi dhe Olsa Broqi nga Peja (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev.nr.92/2018 të 18 dhjetorit 2019 në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.2157/13 të 29 janarit 2019 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.515/2006 të 21 majit 2013.
3. Parashtruesit e kërkesës e pranuan Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme më 2 shtator 2020.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, përmes të cilit pretendohet se parashtruesve të kërkesës u janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113 (1) dhe (7) [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 28 dhjetor 2020, parashtruesit e kërkesës dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 30 dhjetor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi Gjyqtarin Safet Hoxha Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët Selvete Gërxhaliu Krasniqi, kryesuese, Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban.
8. Më 18 janar 2021, parashtruesit e kërkesës u njoftuan për regjistrim të kërkesës dhe nga ata u kërkua që të dorëzojnë dëshminë (fletë-kthesën) që tregon datën e pranimi të vendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme. Të njëjtën datë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
9. Më 18 janar 2021, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Pejë që të dorëzon dëshminë (fletë-kthesën) që tregon datën e pranimi të vendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme nga parashtruesit e kërkesës.
10. Më 20 dhe 26 janar 2021, parashtruesit e kërkesës dhe Gjykata Themelore në Pejë dorëzuan dokumentin e lartpërmendur.
11. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe

e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.

12. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese.
13. Më 21 tetor 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

14. Nga dokumentet e dorëzuara rezulton se XH.B., paraardhësi i parashtruesve të kërkesës më 4 korrik 2006 kishte kërkuar që të vërtetohet se ai është pronar i pjesës së ngastrës kadastrale nr. 2296 të cilën e shfrytëzon i padituri-kundër paditësi B.G. Pas vdekjes së XH.B., procedura është vazhduar nga parashtruesit e kërkesës duke kërkuar që të vërtetohet se ata janë bashkëpronar të pjesëve të barabarta të ngastrës kadastrale 2296 të regjistruar në librat publik nr. 726 ZK Pejë me sipërfaqe prej 38 m². I padituri-kundër paditësi B.G., kishte paraqitur kundërpadi për të njëjtën çështje juridike duke kërkuar që të vërtetohet se ai është bërë pronar i pjesës së ngastrës kadastrale 2296 në bazë të mbajtjes në mirëbesim për më shumë se 20 vite, qysh nga viti 1984 dhe në bazë të gjendjes së atëhershme në terren dhe në bazë të mezhdës të përcaktuar shumë më herët nga pronarët e mëparshëm G dhe K.A.
15. Më 21 maj 2013, Gjykata Themelore në Pejë me Aktgjykim 515/06 vendosi: (i) REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e parashtruesve të kërkesës (paditës-kundër të paditur) me të cilën kanë kërkuar që të vërtetohet se janë bashkëpronarë në pjesë të barabarta të pjesës lindore të ngastrës kadastrale nr.2296 e regjistruar në Certifikatën mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr.724 ZK-Pejë me sipërfaqe 38 m² dhe të detyrohet i padituri-kundër paditës B.G., që parashtruesve t'ua dorëzojë në posedim të lirë dhe faktik të ngastrës në fjalë në afat prej 15 ditësh, (ii) APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e të paditurit-kundër paditës B.G., dhe vërtetohet se i njëjti është pronar në bazë të mbajtjes parashkrimit-fitues i ngastrës kadastrale nr.2296 e regjistruar në Certifikatën mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr.724 ZK-Pejë me sipërfaqe 38 m², (iii) DETYROHEN parashtruesit e kërkesës që të paditurit-kundër paditës B.G., t'ia njohin të drejtën e pronës të përkthyer në pikën II të dispozitivit dhe të lejojnë që i njëjti të regjistrohet pronar në Librat Kadastral në ZKK në Pejë, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.
16. Gjykata Themelore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve ndërgjyqëse dhe sipas detyrës zyrtare administroi prova të ndryshme siç janë kontratat e shitblerjes, kopje të planit të fletës poseduese, ekspertizën e ekspertëve gjeodetë SH.K., dhe D.K., deklaratat e dëshmitarëve

S.B., N.B., A.D., SH.G., L.Z., parashtruesit e kërkesës dhe të paditurin-kundër paditësin B.G.

17. Gjykata Themelore, mes tjerash, shpjegoi: (i) nga deklarimi i dëshmitarit N.B., por edhe të palëve ndërgjyqëse konstatohet se i padituri-kundër paditësi B.G., ka ndërtuar aneksin në pronën e kontestuar para se paraardhësi i parashtruesve të kërkesës XH.B., ta blejë paluajtshmërinë e tij në bazë të kontratës të shitblerjes VR.nr.5409/01; (ii) nga provat e administruara e veçanërisht nga shkresa e lëndës nr.112/06 konstatohet se ish paditësi dhe paraardhës i parashtruesve të kërkesës XH.B., ka mësuar se i padituri-kundër paditësi B.G., ka në posedim pjesën e paluajtshmërisë së kontestuar e cila është pjesë e ngastrës kadastrale 2296, më 22 qershor 2006; (iii) nga deklarimi i dëshmitares L.Z., konstatohet si i padituri-kundër paditësi B.G., e ka blerë paluajtshmërinë e tij në vitin 1984, me gjendje faktike në terren, ndërsa kontratën e shitblerjes Vr. nr. 1441/89 të 5.10.1988 e ka vërtetuar më 30.05.1989; (iv) pretendimi i parashtruesve të kërkesës se kanë fituar të drejtën e pronësisë mbi paluajtshmërinë e kontestuar në bazë të punës juridike-kontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë dhe me regjistrim në librat publik është i pabazuar sepse ata e kanë humbur të drejtën për kthimin e paluajtshmërisë së kontestuar në kuptim të dispozitës së nenit 37.1 dhe 2 të LMTHJ-së, (v) në bazë të dispozitës së nenit 28.4 të LMTHJ-së pala e paditur B.G., ka fituar të drejtën e pronësisë me parashkrim fitues ngase kanë kaluar më shumë se 20 vite që e mban këtë pjesë të paluajtshmërisë, dhe, se (vi) B.G., asnjëherë nuk ka qenë i shqetësuar apo i penguar nga parashtruesit e kërkesës deri në ushtrimin e padisë.
18. Parashtruesit e kërkesës paraqitën ankesë në Gjykatën e Apelit duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit aktgjykimin e goditur ta prish dhe lëndën ta kthej në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.
19. Më 29 janar 2018, Gjykata e apelit me Aktgjykim Ac.nr.2157/13 vendosi që të refuzohet ankesa e parashtruesve të kërkesës dhe të vërtetohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë C.n.515/2006, i 21 majit 2013.
20. Gjykata e Apelit kishte konstatuar: (i) aktgjykimi i kontestuar i gjykatës së shkallës së parë nuk karakterizohet me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore; (ii) gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe se ka dhënë arsye konkrete në vendimmarrjen e saj; (iii) gjykata e shkallës së parë ka zbatuar drejtë të drejtën materiale; (iv) nga shkresat e lëndës shihet qartë se paluajtshmëria e kontestuar prej 38 m² është shfrytëzuar në mirëbesim nga i padituri B.G., shumë më tepër se 20 vite në bazë të posedimit (*usucapio*), respektivisht në bazë të parashkrimit fitues; (v) se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore të parashikuara në nenin 40 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Sendore që përcakton se personi që në mirëbesim ka mbajtur në posedim të pandërprerë një paluajtshmëri ose një pjesë të saj, e fiton pronësinë në të.
21. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesit e kërkesës paraqitën revizion në Gjykatën Supreme duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, zbatim të gabuar të së drejtës materiale me propozim

që revizioni i tyre të aprovohet dhe të shfuqizohen aktgjykimet e dy gjykatave të instancës më të ulët dhe lënda të kthehet për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

22. Më 18 dhjetor 2019, Gjykata Supreme me Aktgjykim [Rev.nr.92/2018] e refuzoi të pabazuar revizionin e parashtruesve të kërkesës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Ac.nr.2157/13 të 29 janarit 2018.
23. Gjykata Supreme kishte konstatuar: (i) gjykatat e instancës më të ulët kanë zbatuar drejtë dispozitat e LPK-së dhe të drejtën materiale kur kanë konstatuar se kërkesëpadia e parashtruesve të kërkesës është e pabazuar ndërsa kërkesa-kundërpadia e B.G., e bazuar; (ii) sipas deklaratave të dëshmitarëve rezulton se B.G., në vitin 1984 ka blerë ngastrën kadastrale 2293/2 ndërsa kontrata shitblerëse e datës 5.10.1988 është vërtetuar në gjykatë nën shenjën V.nr.144/89 më 30.05.1989; (iii) i padituri-kundër paditësi B.G., është mbajtës në mirëbesim i paluajtshmërisë kontestuese për më shumë se 20 vite, duke marrë parasysh faktin që ai ka hyrë në posedim të ngastrës kadastrale 2293/2 qysh nga viti 1984, përfshirë edhe pjesën kontestuese të ngastrës kadastrale 2296, duke e konsideruar si pjesë të ngastrës së blerë; (iv) që nga viti 1984 deri në ditën e parashtrimit të padisë nga tani i ndjeri XH.B., (paraardhësi i parashtruesve të kërkesës) më 22.07.2006 kanë kaluar më shumë se 20 vite të shfrytëzimit të papenguar të pjesës kontestuese të paluajtshmërisë nga i padituri-kundër paditësi B.G.; dhe, se (v) janë plotësuar kushtet e parashikuara me nenin 28.4 të LTHMPJ-së për fitimin e pronësisë ndaj pronës së kontestuar.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

24. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se u janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së.
25. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Gjykata Supreme ka dështuar t'i trajtojë pretendimet e tyre thelbësore të paraqitura në revizion me ç' rast ka shkelur të drejtën për një vendim të arsyetuar në pajtim me garancitë e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së.
26. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se shkelja e garancive të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së konsiston në faktin se nuk ka trajtuar pretendimin e parashtruesve të kërkesës që Gjykata e Apelit dhe Gjykata Themelore në Pejë po ashtu nuk kanë dhënë asnjë arsyetim lidhur me dëshminë e dëshmitarëve S.B., N.B., dhe A.D.
27. Sipas parashtruesve të kërkesës dëshmitarët S.B., N.B., dhe A.D., në mënyrë të saktë kanë sqaruar se i padituri-kundër paditësi B.G., ka uzurpuar pronën kontestuese pas vitit 1999, mirëpo, Gjykata Supreme nuk ka arsyetuar vendimet e kontestuara të gjykatave të instancës më të ulët lidhur pretendimet thelbësore për dëshminë e dëshmitarëve S.B., N.B., dhe A.D.
28. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Gjykata Themelore në Pejë ka shkelur garancitë e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së sepse: (i) në njërën anë, aktgjykimin e ka bazuar mbi deklaratën e një dëshmitare e cila

qartazi ka deklaruar se nuk ka dijeni apo kujtesë për ndërtimet që janë bërë në pronën e kontestuar; kurse, (ii) pa asnjë arsytim nuk i ka shqyrtuar dhe vlerësuar deklaratat e dëshmitarëve të propozuar nga parashtruesit e kërkesës, në anën tjetër.

29. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë: *“Në mesin e provave të cilat janë administruar nga Gjykata Themelore në Pejë, në çështjen juridike C.nr.515/06 ka qenë ekspertiza gjyqësore e kryer nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, e datës 17.07.2012. Nga kjo ekspertizë është vërtetuar fakti se kundërshtari i parashtruesve të kërkesës ka uzurpuar pjesën e paluajtshmërisë të pronës të regjistruar në emër të parashtruesve të kërkesës me sipërfaqe 52 m2. Në lidhje me ekspertizën e lartpërmendur, duhet të sqarohet se parashtruesit e kërkesës përmes padisë dhe kërkesëpadisë së tyre, kanë kërkuar nga Gjykata që atyre t’ua dorëzojë në posedim të lirë vetëm sipërfaqen prej 38 m2 ngase, kjo sipërfaqe është uzurpuar pas vitit 1999. Kështu që, parashtruesit e kërkesës nuk kanë kërkuar nga gjykata që ta detyrojë kundërshtarin e parashtruesve të kërkesës, që t’ua kthejë në posedim të lirë edhe sipërfaqen prej 11 m2, ngase kundërshtari i parashtruesve të kërkesës e ka pasur në shfrytëzim këtë pjesë të paluajtshmërisë, para vitit 1999.”*
30. Parashtruesit e kërkesës, për të mbështetur pretendimet e tyre për një vendim të arsyetuar i referohen aktgjykimeve të Gjykatës në rastet KI97/16, KI22/16, KI72/12 si dhe referencat e përmendura në ato aktgjykime.
31. Parashtruesi i kërkesës kërkojnë nga Gjykata: (i) ta deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së; (iii) ta shpall të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev.nr.92/2018, të 18 dhjetorit 2019; (iv) Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev.nr.92/2018, të 18 dhjetorit 2019 ta kthejë për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese.

Dispozitat ligjore relevante

Ligji mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore, aprovuar nga Kuvendi i RSFJ, në seancën e Dhomës Federative datë 30 janar 1980.

Neni 28

Mbajtësi me mirëbesim dhe i ligjshëm i sendit të luajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fituese me kalimin e kohës prej tre vjetësh.

Mbajtësi me mirëbesim dhe i ligjshëm i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej dhjetë vjetësh.

Mbajtësi me mirëbesim i sendit të luajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej dhjetë vjetësh.

Mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë

send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh.

Trashëgimtari bëhet mbajtës me mirëbesim nga momenti i hapjes së trashëgimisë edhe në rastin kur trashëgimlënësi ka qenë mbajtës me këqbesim, e trashëgimtari këtë nuk e ko ditur as që ka mundur ta dinte kurse koha për parashkrimin fitues fillon të ece nga momenti i hapjes së trashëgimisë.

Neni 37

Pronari mund të kërkojë me padi nga mbajtësi kthimin e sendit të caktuar në mënyrë individuale.

Pronari duhet të provojë se mbi sendin kthimin e të cilit e kërkon ka të drejtën e pronësisë dhe se sendi gjendet nën zotërimin faktik të të paditurit e drejta e paraqitjen së padisë nga paragrafi 1 i këtij neni nuk parashkruhet.

LIGJI Nr. 03/L-154 PËR PRONËSINË DHE TË DREJTAT TJERA SENDORE

Neni 40

Fitimi me parashkrim

1. Personi i cili me mirëbesim e ka njëzet (20) vjet në posedim të pandërprerë një paluajtshmëri ose një pjesë të saj, e fiton pronësinë në të.

2. Personi i cili e ka dhjetë (10) vjet në posedim të pandërprerë një paluajtshmëri dhe nëse ai është regjistruar si posedues pronësor në kadastër e fiton pronësinë në paluajtshmërinë ose në ndonjë pjesë të saj, në qoftë se brenda këtij afati nuk është regjistruar ndonjë kundërshtim lidhur me regjistrimin.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

32. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

34. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton: *“Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”*.
35. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve, 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët parashohin:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

36. Në vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë siç janë cekur më lart, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kanë specifikuar se kontestojnë një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Rev.nr.92/2018] të 18 dhjetorit 2019, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kanë qartësuar të drejtat dhe liritë që ata pretendojnë se janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe kanë dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
37. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (2) specifikon:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtuesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

38. Gjykata rikujton që rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së si dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme në bazë të dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih rastin KIO4/21, parashtuese *Nexhmije Makolli*, aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26; shih gjithashtu rastin KI175/21, parashtuese *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).
39. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si *“qartazi e pabazuar”* në tërësinë e saj ose vetëm përkritazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si *“pretendime qartazi të pabazuara”*. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime *“të shkallës së katërt”*; (ii) pretendime që kategorizohen me një *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”*; (iii) pretendime *“të pambështetura apo të paarsyetuara”*; dhe në fund, (iv) pretendime *“konfuze dhe të paqarta”*. (Shih: më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si *“qartazi të pabazuar”*, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si *“qartazi të pabazuara”*, Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë të 31 gushtit 2019; Pjesa III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 255 deri më 284, shih gjithashtu rastin KIO4/21, cituar më lart, paragrafi 27, si dhe rastin KI175/21, cituar më lart, paragrafi 38).
40. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtuesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin KIO4/21, cituar më lart, paragrafi 28).
41. Gjykata rikujton që parashtuesit e kërkesës në thelb pretendojnë shkelje të së drejtës për një vendim të arsyetuar siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

i) Përkritazi me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

42. Gjykata vëren se esenca e këtij rasti ndërlihet me padinë që paraardhësi i parashtruesve të kërkesës XH.B., e kishte paraqitur më 4 korrik 2006 me ç ‘rast kishte kërkuar që të vërtetohet se ai është pronar i pjesës së ngastrës kadastrale nr. 2296 të cilën e shfrytëzon i padituri-kundër paditësi B.G. Pas vdekjes së XH.B., procedura është vazhduar nga parashtruesit e kërkesës duke kërkuar që të vërtetohet se ata janë bashkëpronar të pjesëve të barabarta të ngastrës kadastrale 2296 të regjistruar në librat publik nr. 726 ZK Pejë me sipërfaqe prej 38 m2. I padituri-kundër paditësi B.G., kishte paraqitur kundërpadi për të njëjtën çështje juridike duke kërkuar që të vërtetohet se ai është bërë pronar i pjesës së ngastrës kadastrale 2296 në bazë të mbajtjes në mirëbesim për më shumë se 20 vite, qysh nga viti 1984 dhe në bazë të gjendjes së atëhershme në terren dhe në bazë të mezhdës të përcaktuar shumë më herët nga pronarët e mëparshëm G dhe K.A. Gjykatat e rregullta përfshirë edhe Gjykatën Supreme konstatuan se në bazë të dispozitës së nenit 28.4 të LMTHJ-së pala e paditur B.G., ka fituar të drejtën e pronësisë me parashkrim fitues ngase kanë kaluar më shumë se 20 vite që e mban këtë pjesë të paluajtshmërisë dhe se ai asnjëherë nuk ka qenë i shqetësuar apo i penguar nga parashtruesit e kërkesës deri në ushtrimin e padisë nga paraardhësi i tyre juridik XH.B., më 22.07.2006.
43. Gjykata vëren se thelbi i ankesës së parashtruesve të kërkesës konsiston në pretendimin e tyre se Gjykata Supreme nuk ka arsyetuar vendimet e kontestuar të gjykatave të instancës më të ulët lidhur pretendimet thelbësore të tyre për dëshminë e dëshmitarëve S.B., N.B., dhe A.D.
44. Në lidhje me këtë, Gjykata duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por duke marrë parasysh edhe veçoritë e saj, siç janë përcaktuar përmes KEDNJ-së, parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, ajo vazhdimisht e ka theksuar dallimin në mes të “kushtetutshmërisë” dhe “ligjshmërisë” dhe ka pohuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabime të fakteve ose interpretimit dhe aplikimit të gabuar të ligjit, që pretendohet se janë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe me KEDNJ. (Shih, në këtë kontekst, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI128/18, parashtrues: *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport SH.A., “Adem Jashari”*, Aktvendim i 28 qershorit 2019, paragrafi 55; KI62/19, parashtrues: *Gani Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 dhjetorit 2019, paragrafët 56-57; KI110/19, parashtrues: *Fisnik Baftijari*, Aktvendim për papranueshmëri i 07 nëntorit 2019, paragrafi 40).
45. Gjykata gjithashtu ka pohuar vazhdimisht se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se ajo nuk mund të vlerësojë vetë faktet të cilat e kanë bërë një gjykatë të rregullt të marrë një vendim e jo një tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. (Shih: në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës KI128/18, cituar më lart, paragrafi 56; dhe KI62/19, cituar më lart, paragrafi 58).

46. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata vlerëson se Gjykata Supreme në mënyrë logjike, të detajuar dhe mbështetje në bazë ligjore ka gjykuar çështjen e parashtruesve të kërkesës me ç ‘rast: (i) ka shpjeguar dhe interpretuar çështjen e shitblerjes së pronës së kontestuar; (ii) afatit për paraqitje të padisë lidhur me parashkrimin fitues në mirëbesim; dhe, (iii) bazën ligjore të fitimit të pronësisë bazuar në parashkrim fitues si rrjedhojë e mbajtjes në mirëbesim pandërprerë për më shumë se 20 vite nga i padituri-kundër paditësi B.G.
47. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson konstatimet e Gjykatës Supreme: (i) gjykatat e instancës më të ulët kanë zbatuar drejtë dispozitat e LPK-së dhe të drejtën materiale kur kanë konstatuar se kërkesëpadia e parashtruesve të kërkesës është e pabazuar ndërsa kërkesa-kundërpadia e B.G., e bazuar; (ii) sipas deklaratave të dëshmitarëve rezulton se B.G., në vitin 1984 ka blerë ngastrën kadastrale 2293/2 ndërsa kontrata shitblerëse e datës 5.10.1988 është vërtetuar në gjykatë nën shenjën V.nr.144/89 më 30.05.1989; (iii) i padituri-kundër paditësi B.G., është mbajtës në mirëbesim i paluajtshmërisë kontestuese për më shumë se 20 vite, duke marrë parasysh faktin që ai ka hyrë në posedim të ngastrës kadastrale 2293/2 qysh nga viti 1984, përfshirë edhe pjesën kontestuese të ngastrës kadastrale 2296, duke e konsideruar si pjesë të ngastrës së blerë; (iv) që nga viti 1984 deri në ditën e parashtrimin të padisë nga tani i ndjeri XH.B., (paraardhësi i parashtruesve të kërkesës) më 22.07.2006 kanë kaluar më shumë se 20 vite të shfrytëzimit të penguar të pjesës kontestuese të paluajtshmërisë nga i padituri-kundër paditësi B.G.; dhe, se (v) janë plotësuar kushtet e parashikuara me nenin 28.4 të LTHMPJ-së për fitimin e pronësisë ndaj pronës së kontestuar.
48. Gjykata vëren se pjesa relevante e arsytimit të Gjykatës Supreme, përcakton:

“Mbi gjendjen e vërtetuar faktike është aplikuar drejtë e drejta materiale përmes aplikimit të dispozitave të nenit 20 dhe 28 paragrafi 4 i Ligjit për marrëdhëniet themelore juridiko pronësore [...] me nenin 20 të këtij ligji parashihet që e drejta pronësore fitohet sipas vet ligjit, në bazë të punës juridike dhe trashëgimisë si dhe me vendimin e organit shtetëror sipas mënyrës dhe kushteve të përcaktuara me ligj. Neni 28.4 i Ligjit për marrëdhëniet themelore juridiko pronësore parasheh që mbajtësi në mirëbesim mbi të cilën tjetri ka të drejtën pronësore, fiton të drejtën pronësore mbi atë send përmes mbajtjes me kalimin e kohës prej 20 viteve. Meqë gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar që i padituri-kundër paditësi, shfrytëzon pjesën kontestuese të paluajtshmërisë prej vitit 1984 dhe se askush nuk e ka penguar përfshirë këtu edhe paditësin paraardhës dhe se ai ka qenë i bindur se shfrytëzon paluajtshmërinë e tij të cilën e ka blerë nga G.M., mu për këtë gjykatat e instancës më të ulët kanë konstatuar se i njëjti ka qenë mbajtës me mirëbesim për më shumë se 20 vite, marrë parasysh se procedura kontestimore nga paraardhësi juridik i paditësve ishte iniciuar më vonë me datën 04.07.2006, është arsyeja pse është pranuar kërkesa e tij e kundërpadisë. Një qëndrim të tillë e pranon në tërësi edhe Gjykata Supreme prandaj pretendimet nga revizioni lidhur me atë se gabimisht është aplikuar ligji për pronësinë, nuk janë të bazuara sepse i njëjti as nuk është aplikuar nga gjykatat e instancës më të ulët por është aplikuar ligji për marrëdhëniet themelore juridiko pronësore. Është e vërtetë që paraardhësi juridik i paditësve-kundër paditurve në vitin 2001 ka blerë ngastrën kadastrale 2269 në vitin 2001 dhe se pjesa kontestuese në

të cilën i padituri-kundër paditësi ka ndërtuar, gjendet në atë ngastër kadastrale me sipërfaqe prej 38 m², mirëpo kjo do të ishte me rëndësi po qe se nuk do të ishin të plotësuara kushtet për mbajtje siç është rasti konkret, e të cilën i padituri-kundër paditësi ka kërkuar me kundërpadinë e tij. Nuk është i bazuar pretendimi i revizionit se gjykatat e instancave më të ulët gabimisht kanë aplikuar nenin 37 1 dhe 2 të Ligjit për marrëdhëniet themelore juridiko-pronësore. Me nenin e sipër cekur, ligji garanton mbrojtjen e së drejtës pronësore, gjë që me aktgjykimin e shkallë së parë nuk u vu në dyshim. Meqë ana e kundërt është thirrur në fitimin e të drejtës pronësore përmes mbajtjes duke parashtruar kundërpadinë në këtë kontekst, kurse me procedurë është vërtetuar se janë plotësuar të gjitha kushtet në kuptim të nenit 28 4 të ligjit për marrëdhëniet themelore juridiko pronësore, e njëjta është bërë pronare e pjesës së kontestuar të paluajtshmërisë.”

49. Lidhur me të drejtën për një vendim të arsyetuar, Gjykata rithekson se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së obligojnë gjykatat që të arsyetojnë vendimet e tyre, mirëpo kjo nuk mund të kuptohet sikur kërkohej përgjigje e detajuar ndaj secilit argument (shih rastet e GJEDNJ-së, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, cituar më lart, paragrafi 26; *Perez kundër Francës*, Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 81; *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61; *Jahnke dhe Lenoble kundër Francës*, Vendim mbi Pranueshmëri i 29 gushtit 2000). Megjithatë, në rastet ku argumentet e palës janë vendimtare për përfundimin e rastit, atëherë, nevojitet përgjigje specifike dhe shprehimore (shih rastet e GJEDNJ-së, *Ruiz Torija kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 30; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 28).
50. Duke iu kthyer rrethanave të rastit konkret, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta përfshirë edhe Gjykatën Supreme vendimmarrjen e saj e ka bazuar në administrimin e provave të ndryshme siç janë kontratat e shitblerjes, kopje të planit të fletës poseduese, ekspertizën e ekspertëve gjeodetë SH.K., dhe D.K., deklaratat e parashtruesve e kërkesës dhe të paditurit-kundër paditësit B.G., përfshirë dhe deklaratat e dëshmitarëve S.B., N.B., dhe A.D.
51. Nga sa më sipër, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta përfshirë edhe Gjykatën Supreme pas administrimit gjithëpërfshirës të provave në dispozicion të tyre, kanë nxjerrë vendime që favorizojnë palën kundërshtare në vend të parashtruesve të kërkesës. Kjo në vetvete nuk e bën procesin gjyqësor kundërkushtetues dhe në cenim të së drejtës për një vendim të arsyetuar siç pretendojnë parashtruesit e kërkesës.
52. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se mos dhënia e përgjigjes nga Gjykata Supreme lidhur me deklaratat e dëshmitarëve S.B., N.B., dhe A.D., nuk është çështje përcaktuese në rezultatin përfundimtar të këtij rasti, sepse gjykatat e rregullta përfshirë edhe Gjykatën Supreme kanë bazuar vendimet e tyre në një mori provash siç janë kontratat e shitblerjes, kopje të planit të fletës poseduese, ekspertizën e ekspertëve gjeodetë SH.K., dhe D.K., deklaratat e parashtruesve e kërkesës dhe të paditurit-kundër paditësit B.G., përfshirë dhe deklaratat e dëshmitarëve S.B., N.B., dhe A.D., me ç’rast kanë konstatuar se pala

kundërshtare B.G., për më shumë se 20 vite ka mbajtur në mirëbesim dhe në mënyrë të pandërprerë paluajtshmërinë e kontestuar.

53. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta kanë dëgjuar deklaratat e dëshmitarëve S.B., N.B., dhe A.D., dhe të njëjtat i kanë ballafaquar me deklaratat e dëshmitarëve tjerë por edhe me provat tjera që si rrjedhojë logjike ka çuar deri tek konkluzioni se pala kundërshtare B.G., për më shumë se 20 vite ka mbajtur në mirëbesim dhe në mënyrë të pandërprerë paluajtshmërinë e kontestuar. Prandaj, kjo është çështje e diskrecionit të gjykatave të rregullta për të vendosur se cilat prova dhe deklarata janë më të besueshme se tjerat për vendosjen e drejtë dhe meritore të një rasti dhe nuk ngre çështje të parregullsisë së procesit gjyqësor apo shkelje të së drejtës për një vendim të arsyetuar.
54. Duke vlerësuar procedurat e zhvilluara në tërësi në gjykatat e rregullta përfshirë edhe Gjykatën Supreme, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës përfituan nga procedura kontradiktore dhe se ata ishin në gjendje të paraqesin në faza të ndryshme të procedurës pretendimet dhe provat që ata i konsideruan të rëndësishme për rastin e tyre; ata kanë pasur mundësinë të hedhin poshtë në mënyrë efektive pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare; gjykatat e rregullta dëgjuan dhe shqyrtuan të gjitha pretendimet e tyre, të cilat, shikuar objektivisht, ishin të rëndësishme për zgjidhjen e rastit; arsyet faktike dhe ligjore për vendimin e kontestuar janë dhënë në hollësi dhe procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta (shih *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafët 29 dhe 30, shih gjithashtu rastet e Gjykatës KI22/19, parashtrues *Sabit Ilazi*, aktvendim i 7 qershorit 2019, paragrafi 42 si dhe rasti KI128/18, cituar më lart, paragrafi 58).
55. Prandaj, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç specifikohet në rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 21 tetor 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Safet Hoxha

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese




Jresa Caka-Nimani